

Nr. 216/6 Prot

Korçë më, 21.03.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje tubo dhe materiale për rrjetin e kanalizimeve

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44163130-0  
Tuba kanalizimesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.883.000 (katërmilionetetëqindetëdhjetëetremijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:



- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 97.660 (nëntëdhjetëeshtatë mijëegjashhtëqinde gjashtëdhjetë) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.
- c. Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1
- d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

K. Dishnica

M. Kaluci

O. Hysenlli



## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1.953.200 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, si dhe sipas parashiktimit të nenit 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.


Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*


Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*


K. Dishnica



M. Kaluci



O. Hysenlli



## 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 976.600 leke pa TVSH (20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate) .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4, b ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

" Për kontratat e mallrave vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ”


Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ( 20% x 4.883.000 leke= **976.600 leke**) . Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

M. Kaluci



2.2.2 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT , shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mostra për mallrat furnizues, **të cilat duhet të dëshmojnë qartë që cilësia e tubove , brylave dhe elementëve lidhës është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.**

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime , VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime, neni 40, pika 6, gërma ”a”, si dhe Udhëzimi i APP, Nr. 03, datë 12.04.2022 ”Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

Autoriteti kontraktor u kërkon operatorëve ekonomikë , si dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale , të përcaktuara në dokumentet e tenderit Shtojca 5 Specifikimet teknike , të dorëzojnë mostra të të gjitha llojeve të tubove të kërkuara , me gjatësi jo më të vogël se 0,5 m , të brylave , si dhe të elementëve lidhës (gjithsej 12 mostra) sepse e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

Mostrat kërkohen me qëllim që cilësia e tubove, brylave, si dhe elementëve lidhës të jetë në përputhje me kërkesat e AK.

Autoriteti kontraktor përcakton qartë **procedurën për dorëzimin e mostrave**, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces, si më poshtë:

Paraqitja dhe dorëzimi i mostrave duhet të bëhet në ditën e hapjes së tenderit datë 03.04.2023, në orën 10.00, në zyrën e prokurimeve të UKRK Sh.A, tek KVO.

KVO do të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave , duke mbajtur Procesverbal , në të cilin do të pasqyrohen detaje që përshkruajnë mostrat e administruara, procesverbal i cili nënshkruhet nga të dy palët, nga KVO dhe nga ofertuesi i pranishëm .

Procesverbali i vihet në dispozicion ofertuesit të pranishëm.

Në rast se ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato do të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.


Në çdo rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

M. Kaluci



2.2.3 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike për mallrat e kërkuara të përcaktuara në DT shtojca 5 Specifikimet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **katalogë teknike për të gjithë** mallrat furnizues, **ku të jepet qartë** që mallrat , janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Te gjitha dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të jenë të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime , VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime, neni 40, pika 6, gërma ”b”.


Plotësimi i këtij kriteri i shërben garantimit të ekzekutimit të objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Ing. Marsida Kaluci



Nr.	Përshkrimi i mallit	Njesia	Sasia
1	Tubo PVC Db 100mm	ml	204
2	Tubo PVC Db 160mm	ml	1002
3	Tubo HDPE të brinjëzuar SN 4 Db 200mm	ml	402
4	Tubo HDPE të brinjëzuar SN 8 Db 200 mm	ml	204
5	Tubo HDPE të brinjëzuar SN 4 Db 250mm	ml	330
6	Tubo HDPE të brinjëzuar SN 4 DN 315 mm	ml	696
7	Tubo HDPE të brinjëzuar SN8 Db 600 mm	ml	90
8	Bryl PVC Db 160mm	cope	200
9	Element lidhes Y PVC D 100 mm	cope	60
10	Element lidhes T PVC D 100 mm	cope	50
11	Element lidhes T PVC D 160 mm	cope	50
12	Element lidhes Y PVC D 160 mm	cope	30
13	Gomine D 100 mm	cope	102
14	Gomine D 160 mm	cope	100

1. Tubo PVC DN100 , sasia 204 ml

Diametri DN i referohet diametrit të brendshëm të tubove ( ± 2%) .

Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për rezistencën në presion (SDR) -41.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 3 ml.*

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

- Emrin e prodhuesit
- Rezistencën në presion (SDR)

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në mënyrë rezistente (permanente).  
Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

2. Tubo PVC DN 160, sasia 1002 ml


Diametri DN i referohet diametrit të brendshëm të tubove ( ± 2%) .

Tubot PVC për kanalizimet të jenë të llogaritura për ngarkesa të rënda për Rezistencën në presion (SDR) -41.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 3 ml.*

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

Ing. Marsida Kaluci

6 

- Emrin e prodhuesit
- Rezistencën në presion (SDR)

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

3. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m<sup>2</sup>) DN 200, sasia 402 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë

Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove ( $\pm 2\%$ ).

Këto tuba (DN 200) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brëndshme ngjyrë të çelur.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.*

Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre.

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

- Emrin e prodhuesit
- Klasën e tubit

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

4. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 KN/m<sup>2</sup>) DN200, sasia 204 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë

Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove ( $\pm 2\%$ ).

Këto tuba (DN 200) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brëndshme ngjyrë të çelur.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.*


Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre.

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

- Emrin e prodhuesit
- Klasën e tubit

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

Ing. Marsida Kaluci



5. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m<sup>2</sup>) DN250, sasia 330 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë

Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove ( $\pm 2\%$ ).

Këto tuba (DN 250) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.*

Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre.

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

- Emrin e prodhuesit
- Klasën e tubit

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

6. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m<sup>2</sup>) DN 315, sasia 696 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë.

Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove ( $\pm 2\%$ ).

Këto tuba (DN 315) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.*

Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre.

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:


- Emrin e prodhuesit
- Klasën e tubit

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

7. Tubo HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 KN/m<sup>2</sup>) DN 600, sasia 90 ml – me elementë bashkues dhe guarnicione lidhës plastikë.

Diametri i specifikuar DN i referohet diametrit të brendshëm (ID) të tubove ( $\pm 2\%$ ).

Ing. Marsida Kaluci





Këto tuba (DN 600) janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar. Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme ngjyrë të çelur.

*Gjatësia e tubove duhet të jetë 6 ml.*

Tubot duhet të jenë polietile ose derivate të tyre.

Çdo tub duhet të ketë të shënuar në të në mënyrë permanente të dhënat si më poshtë:

- Emrin e prodhuesit
- Klasën e tubit

Ky shënim duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shënuar në menyrë rezistente (permanente). Tubot duhe të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.

*Tubot duhet të kenë rezistencë të lartë kundrejt thyerjes si dhe goditjeve mekanike.*


*Tubot HDPE të brinjëzuar, Klasa SN8 (8 KN/m<sup>2</sup>), si dhe tubot HDPE të brinjëzuar, Klasa SN4 (4 KN/m<sup>2</sup>) duhet jenë të provuara në laborator sipas Standardit EN 13476-1 ose sipas standardit shqiptar SSH ekuivalent i këtij standardi, Standardit EN 13476-2 ose sipas standardit shqiptar SSH ekuivalent i këtij standardi , Standardit EN 13476-3 ose sipas standardit shqiptar SSH ekuivalent i këtij standardi .*

*Guarnicionet që lidhin tubot duhet të jenë në përshtatje me standardet e lartpermendura. Prova e hermeticitetit duhet të jetë konform Standartit DIN EN 1610 ose sipas standardit shqiptar SSH ekuivalent i këtij standardi.*

8. Bryla PCV DN 160, sasia 200 copë
9. Element lidhes Y PVC D 100 mm, sasia 60 copë
10. Element lidhes T PVC D 100 mm, sasia 50 copë
11. Element lidhes T PVC D 160 mm, sasia 50 copë
12. Element lidhes Y PVC D 160 mm, sasia 30 copë
13. Gomine D 100 mm , sasia 102 copë
14. Gomine D 160 mm, sasia 100 copë

**Furnizuesi duhet që të gjitha materialet t'i shoqërojë me certifikatën e prodhuesit , që vërteton përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara .**

Ing. Marsida Kaluci



**Afatet e lëvrim:**

Afati i lëvrim do të jetë: 30 ditë kalendarike , duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.  
Mallrat duhet të dorëzohen tek UKRK Sh.A.

Ing. Marsida Kaluci

